

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Seanca plenare**

Seanca nr. 02-33/20-06

Prishtinë, më 21 shtator 2006, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën në fillim e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 95 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE:**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, z.Agim Çeku, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së,
3. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për miratimin e listës së kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryetari** i informoi deputetët për kërkesën e Grupit Parlamentar 6+ që Kuvendi ta rishqyrtojë vendimin e 14 shtatorit lidhur me rekomandimin e panelit në Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

Ai kërkoi që kjo kërkesë të radhitet në rend dite të kësaj seance.

Kryetarët e grupeve parlamentare e mbështetën kërkesën e Grupit Parlamentar 6+.

Kryetari e hodhi në votim kërkesën e Grupit parlamentar 6+. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----74;

Kundër----- 11.

Kryetari konstatoi: kërkesa e Grupit Parlamentar 6+ u radhit në rend dite të kësaj seance.

**Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, shprehu shqetësimet për shpërthimet që kishin ndodhur ditëve të fundit në Gjilan, Ferizaj dhe në Klinë. Ai kërkoi që Kuvendi të miraton një deklaratë, me të cilën dënon këto akte të dhunës.

**Bajrush Xhemajli**, kërkoi që të ndriçohet incidenti i ndodhur para një jave në hollin e Kuvendit kur një pjesëtar i sigurimit të ndërtesës kishte rrahur një gazetar, që ishte nisur për ta intervistuar deputetin Xhemajli.

**Kryetari** tha se ka filluar procedura kundër sjelljes së atij polici.

**Xhavit Haliti**, anëtari i Kryesisë së Kuvendit, mbështeti kërkesën e Sabri Hamitit, por kërkoi që Kuvendi të debatohet në një seancë të veçantë për gjendjen e sigurisë në vend, ku do të raportonin ministri i Punëve të Brendshme dhe komisari i Policisë.

Opinione dhe sugjerime lidhur me këto propozime dhanë këta deputetë: **Alush Gashi, Jakup Krasniqi, Hajredin Kuçi, Nekibe Kelmendi, Ylber Hysa, Gjergj Dedaj, Xhevat Bislimi, Gjylnaze Sylja, Sabit Rrahmani dhe Numan Baliq**, që i janë bashkangjitur traanskriptit.

Kryetari e hodhi në votim kërkesën e Sabri Hamitit. Rezultati ishte si vijon:

Për-----64;

Kundër----- 4.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi me shumicë votash miratoi kërkesën e deputetit Sabri Hamiti. Kërkohet nga kryetarët e grupeve parlamentare, në bashkëpunim me propozuesin ta harmonizojnë tekstin e deklaratës dhe t'ia paraqesin Kuvendit për miratim.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Xhavit Halitit. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----71;

Kundër-----12.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi me shumicë votash miratoi propozimin e Xhavit Halititit për ta shqyrtuar në seancën e ardhshme gjendjen e sigurisë në vend, ku do të raportojnë para deputetëve të Kuvendit përgjegjësit e fushës së sigurisë.

Me këto plotësime Kuvendi miratoi rendin e ditës së kësaj seance.

## **2. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, z.Agim Çeku, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së**

**Kryetari** e ftoi propozuesin e interpelancës për ta arsyetuar atë.

**Jakup Krasniqi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se edhe pse jemi në opozitë, jemi shumë të interesuar që Kosova në këto momente të ketë dhe të udhëhiqet nga një kryeministër që e ushtron autoritetin e tij mbi tërë kabinetin qeveritar. Ne konsiderojmë se letra e Kryesisë së LDK-së është atak mbi ekzekutivin, e relativizon autoritetin e kryeministrit, fuqinë e tij vendimarrëse e politike, autoritetin e tij në raport me faktorin ndërkombëtar, krijon institucion jofunksional e shumësi kryeministrash, shkapërderdh përgjegjësitë, humb kontrollin në mbikëqyrje, në administrim të mjeteve financiare dhe në menaxhimin e resurseve njerëzore, në kontrollin dhe në administrimin e lartë të shtetit.

Në vazhdim deputeti Krasniqi shkoqiti të gjitha pikat e letrës së Kryesisë së LDK-së adresuar kryeministrit Çeku për koordinimin e veprimeve të Qeverisë, sipas marrëveshjes së koalicionit qeverisës, si dhe paraqiti qëndrimet e Grupit Parlamentar të PDK-së lidhur me to.

**Kryetari** e ftoi kryeministrin e Kosovës t'i përgjigjet interpelancës së Grupit Parlamentar të PDK-së.

**Kryeministri Agim Çeku** tha se do të përpiqem ta sqarojë pozicionin tim ndaj letrës në fjalë. Unë jam kryeministër legjitim i Kosovës, i nominuar nga presidenti, i votuar dhe i zgjedhur nga ky Kuvend. Kompetencat e mia burojnë vetëm nga Korniza Kushtuese e Kosovës dhe nga Rregullorja e Punës së Qeverisë së Kosovës dhe asnjë letër tjetër pa fuqi ligjore nuk mund t'i ndryshojë apo t'i kufizojë kompetencat e mia. Dua t'ju siguroj se deri më tani gjatë punës sime kam pasur dhe kam mbështetjen e plotë të partnerëve të koalicionit.

Rolin paraprak që e ka marrë z. zëvendëskryeministri Lutfi Haziri nga partia e tij për asnjë çast nuk e ka penguar funksionalitetin e Qeverisë së Kosovës dhe as nuk e shoh si tendencë për krijimin e një fraksioni brenda Qeverisë, por si synim për harmonizimin e brendshëm të veprimeve brenda LDK-së. Unë bashkëpunoj ngushtë me z. Haziri dhe me kolegët e tjerë nga koalicioni dhe jemi të përkushtuar në kryerjen e detyrave ditore të Qeverisë së Kosovës.

Sa i përket çështjes që ka të bëjë me pozicionet e larta dhe me Qeverinë, kjo ka të bëjë ekskluzivisht me marrëveshjen ndërmjet partive të koalicionit qeveritar. Liderët e partive në koalicion janë dakorduar për ndarjen e posteve në Qeveri, të cilën unë e udhëheq. Shërbyesit civilë nuk janë pjesë e kësaj marrëveshjeje, ata u nënshtrohet ligjit dhe rregulloreve dhe emërohen përmes KELK-ut.

Sa i përket rolit udhëheqës të LDK-së në koordinim me AAK-në ,siç është thënë në letër, në procesin e statusit të Kosovës, mund të them: Kosova në këtë moment është duke kaluar nëpër një proces shumë të rëndësishëm. Procesi negociator drejtohet nga presidenti dhe ky grup është mandatar nga ky Kuvend. Për punën tonë kemi dëshmuar se kemi një unitet, harmoni dhe konsensus të plotë brenda grupit.

I gjithë potenciali ynë në këtë fazë duhet të përqendrohet në çështje më madhore, si statusi final i Kosovës, zhvillimi ekonomik, integrimi i minoriteteve, zbatimi i standardeve, siguria, rritja e mirëqenies së qytetarëve të Kosovës e shumë tema të tjera jetike.

Ne jemi të vetëdijshëm dhe pranojmë argumentin se ka hapësirë për përmirësim të funksionalitetit të Qeverisë sonë. Unë gjithmonë i përshëndes rekomandimet dhe kritikrat që kanë për qëllim reformat pozitive që direkt apo indirekt kontribuojnë në qeverisje më të mirë dhe në rritjen e standardit jetësor të qytetarëve të Kosovës.

**Kryetari** hapi debatin lidhur me këtë interpelancë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime për interpelancën e kryeministrit Çeku lidhur me letrën e Kryesisë së LDK-së për koordinimin e veprimeve të Qeverisë sipas marrëveshje së koalicionit qeverisës dhanë këta deputetë: **Alush Gashi, Hajredin Kuçi, Gjylane Sylja, Teutë Sahatqija, Numan Baliq, Xhavit Haliti, Gani Koci, Hydajet Hyseni, Fetah Berisha, Ymer Muhaxheri, Sabri Hamiti dhe Gjergj Dedaj**, që i janë bashkangjitur transkriptimit.

Në fund të debatit propozuesi i interpelancës, **Jakup Krasniqi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së tha se nuk kemi marrë përgjigjen e duhur. Ai parqiti qëndrimet e Grupit Parlamentar të PDK-së lidhur me punën e Qeverisë.

### **3. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për miratimin e listës së kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë**

**Kryetari** e ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për ta arsyetuar rekomandimin për emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

**Sadudin Berisha**, nënkryetar i këtij komisioni, e arsyetoi rekomandimin për emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Komisioni ka shqyrtuar listën e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të rekomanduar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, shtoi z. Berisha dhe ka ardhur në përfundim t'i propozojë Kuvendit si vijon:

1. Ta miratojë emërimin e 17 gjyqtarëve dhe të prokurorëve.
2. Të mos i miratojë dy kandidatë për shkak të kaluarës së tyre dhe të kërkojë

informacione shtesë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe

3. Të mos miratojë tre kandidatë, dy prej tyre për shkak të mungesës së përvojës së duhur në fushën juridike, kurse për njërin për shkak të dyshimit të vërtetësisë së diplomës, për të cilat kërkon informacione shtesë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

**Jakup Krasniqi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së tha se ka rezerva për kandidatët e propozuar për gjyqtarë dhe prokurorë dhe për sistemin e drejtësisë në Kosovë në tërësi. Sistemi gjyqësor duhet të ndërtohet me njerëz të rinjë, që kanë një të kaluar të pastër. Grupi Parlamentar i PDK-së është kundër këtij propozimi.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me rekomandimin e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për miratimin e listës së kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë dhanë këta deputetë: **Alush Gashi, Gjylnaze Syla, Nazim Jashari, Berat Luzha, Gani Koci dhe Hydajet Hyseni**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votim rekomandimin e Komisionit. Rezultati ishte si vijon:

Për-----42;

Kundër----- 26.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës me shumicë votash mori këtë

## V E N D I M

**I.** Miratohet rekomandimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e këtyre gjyqtarëve dhe të prokurorëve:

1. Agron Berisha - gjyqtar në Gjykatën Komunale-Pejë,
2. Sahide Gashi - gjyqtare në Gjykatën Komunale-Pejë,
3. Agim Ademi - gjyqtar në Gjykatën Komunale-Gjilan,
4. Vesel Ismaili - gjyqtar në Gjykatën Komunale-Prishtinë,
5. Driton Muharremi - gjyqtar në Gjykatën Komunale-Prishtinë,
6. Naime Krasniqi - gjyqtare në Gjykatën Komunale- Prishtinë,
7. Hasim Sugojeva - gjyqtar në Gjykatën Komunale-Ferizaj,
8. Bashkim Hyseni - gjyqtar në Gjykatën Komunale-Ferizaj,
9. Sadije Gerguri - gjyqtare në Gjykatën Komunale- Mitrovicë,
10. Nenad Llaziq - gjyqtar në Gjykatën Komunale-Prishtinë, dega në Graçanicë,
11. Resat Karanxha - gjyqtar në Gjykatën për Kundërvajtje-Prizren,
12. Radica Vidosavleviq - prokurore në Prokurorinë Komunale – Mitrovicë,

13. Dejan Miliq - gjyqtar në Gjykatën Komunale- Mitrovicë,
14. Ibrahim Rexhepi - gjyqtar në Gjykatën për Kundërvajtje-Prizren,
15. Edija Sezairi - gjyqtare në Gjykatën Komunale-Prizren,
16. Milena Gjeriq - gjyqtare në Gjykatën Komunale- Mitrovicë,
17. Javorka Priliçeviq - gjyqtare në Gjykatën Komunale- Ferizaj-dega Shtërpçë,

**II.** Kuvendi nuk miratoi rekomandimin Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e këtyre kandidatëve:

1. Gjorgje Aksiq, i rekomanduar për gjyqtar në gjykatën Supreme të Kosovës,
2. Vasile Arsiq, i rekomanduar për gjyqtar në Gjykatën Komunale në Gjilan.

Për kandidatët nën pikat 1 dhe 2 Kuvendi kërkon informacione shtesë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për të kaluarën e tyre.

3. Veton Dërguti, i rekomanduar për gjyqtar në Gjykatën Komunale në Rahovec
4. Samile Mushkolaj, e rekomanduar për gjyqtare në Gjykatën Komunale në Gjakovë dhe
5. Rrahman Asllani, i rekomanduar për gjyqtar në Gjykatën Komunale në Prizren.

Për kandidatët nën pikat 3 dhe 4 Kuvendi kërkon informacione shtesë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për përvojën e tyre në lëmin juridike, kurse për kandidatin nën pikën 5 kërkohet vërtetësia e diplomës.

#### **4. Deklarata e Kuvendit**

Propozuesi **Sabri Hamiti** – paraqiti tekstin e deklaratës, të harmonizuar me mendimet e kryetarëve të grupeve parlamentare, si vijon:

Kuvendi i Kosovës, në seancën plenare të datës 21 shtator 2006 lidhur me shpërthimet e fundit në Kosovë, lëshon këtë

#### **D E K L A R A T Ë**

1. Kuvendi i Kosovës dënon me forcë shpërthimet e ditëve të fundit në Gjilan, në Ferizaj e në Klinë, duke i konsideruar akte dhune e terrori që rrezikojnë jetën e njerëzve dhe krijojnë pasiguri në vend,
2. Kuvendi i Kosovës kërkon nga SHPK-ja, nga Policia e UNMIK-ut dhe nga përgjegjësit e tjerë të sigurisë në Kosovë, që kryesit e këtyre akteve të dhunës e të terrorit të nxirren para ligjit dhe t'i parandalojnë veprimet që rrezikojnë sigurinë e qytetarëve të Kosovës dhe
3. Kuvendi i Kosovës vlerëson që aktet e dhunës dhe të terrorit prishin pamjen e Kosovës para botës dhe dëmtojnë rënd politikisht procesin e pavarësisht të saj.

Kryetari e hodhi në votim propozimin. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----63;  
Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi tekstin e deklaratës së paraqitur nga deputeti Sabri Hamiti.

#### **5. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar 6+ për rishqyrtimin e rekomandimit të panelit të veçantë lidhur me mocionin në Ligjin për përdorimin e gjuhëve**

**Kryetari** e hodhi në votim kërkesën e Grupit Parlamentar 6+ për rishqyrtimin e vendimit të seancës plenare të 14 shtatorit lidhur me rekomandimin e panelit të veçantë në Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----59;  
Kundër----- 7.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës me shumicë votash mori këtë

### **V E N D I M**

1. Shfuqizohet Vendimi i seancës plenare të 14 shtatorit 2006 dhe miratohet rekomandimi i panelit të veçantë në Ligjin për përdorimin e gjuhëve si vijon:  
“Në komunat e banuara nga një bashkësi, gjuha amtare e të cilës nuk është gjuhë zyrtare dhe e cila përbën së paku 5 përqind të popullsisë së përgjithshme të asaj komune, gjuha e asaj bashkësie do të ketë statusin e gjuhës zyrtare në atë komunë dhe do të përdoret barabar me gjuhët zyrtare. Pavarësisht prej kësaj që u tha më lart, në mënyrë të veçantë në komunën e Prizrenit gjuha turke do të ketë statusin e gjuhës zyrtare”.

**Shënim:** Pjesë përbërëse e këtij procesverballi është transkripti i kësaj seance.

**Kryetari** seancën e deklaroi të mbyllur në orën 14:00.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
**Kolë BERISHA**

E hartoi

**Sektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**